



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 25 Datë 24.06.2020

SHOYRTIM RAPORTI AUDITIMI

Autoriteti kontraktor	TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR
Organi auditues	Sektori i Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Kulturës
Numri i procedurave të audituara	21 (njëzetë e një)
Lloji i procedurës/ave të audituar	1 (një) Procedurë “Kërkesë për Propozim”. 20 (njëzetë) Procedura prokurimi me vlerë të vogël.
Konstatimet kryesore	1. Autoriteti Kontraktor ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, lidhur me tejkalimin e kufirit monetar, për zhvillimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël. 2. Autoriteti Kontraktor ka vepruar në kundërshtim me nenin 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe nenin 61 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, lidhur me hartimin dhe argumentimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, në procedura prokurimi të audituara. 3. Autoriteti Kontraktor ka vepruar në kundërshtim me nenin 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik të shpallur fitues, në procedura prokurimi të audituara.
Masat e marra	Në bazë të nenit 72, pika 2, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, APP vendosi të propozojë marrjen e masës disiplinore ndaj 7 (shtatë) personave, të evidentuar përgjegjës, për shkelje dhe mangësi të konstatuara në vendim.